



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>2-D/DPK</u> Nr. i faq. _____ Broi i stranicave _____ Nr. pages _____	Nr. Prot. <u>01-1182/14</u> Br. Prot. _____ Prot No. _____ Data _____ Datum _____ Date <u>31.03.2014</u> PRISTINE

DATË/A:	25.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	Visar BERISHA, Drejtor i Drejtorisë për Financa dhe Pronë në Komunën e Prishtinës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik



I nderuar,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

O P I N I O N

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesë nga z. Visar Berisha - Drejtor i Drejtorisë për Financa dhe Pronë në Komunën e Prishtinës, me numër të protokolit 03-888/14, me të cilën është kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të shqyrtohet situata e mundshme e konfliktit të interesit të zyrtarit në fjalë, që krahas ushtrimit të funksionit të drejtorit të Drejtorisë për Financa dhe Pronë në Komunën e Prishtinës, të ushtroj edhe funksionin Administratorit në kompaninë "Be Research" e cila është e regjistruar në Shqipëri.

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se Agjencia kundër Korrupsionit është institucion i pavarur të cilit me ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara me ligj.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit). Në bazë të këtij ligji pozita juaj si drejtor i Drejtorisë për Financa dhe Pronë në Komunën e Prishtinës hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Në bazë të nenit 8 të këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit dhe kanë për detyrë të parandalojnë dhe të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit.

Ndërsa, Agjencia kundër Korrupsionit, ndër të tjera, bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eproreve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave (neni 19, pika 1.5).

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, në pajtim me dispozitat në fuqi dhe mandatin e përcaktuar ligjor, ju njoftojmë se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nuk ka dispozita të veçanta për bizneset të cilat zyrtarët e lartë i kanë të regjistruara jashtë vendit.

Mirëpo, në bazë të këtij ligji jeni i obliguar që të bëni deklarinë “rast për rast” të interesave private, në rastet kur mund të keni rol përcaktues në një vendimarrje konkrete në lidhje me biznesin tuaj apo çfarëdo interesi tjetër privat.

Kjo është e rregulluar me nenin 13 (paragrafi 1), ku thuhet se: “Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarinë paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit”.

Rastet e deklaramit të konfliktit rast për rast të interesave private janë të parapara në paragrafin 2 të këtij neni, në të cilin thuhet: “*Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur*”.

Ndërsa, mënyra e deklarimi është me shkrim, siç parashihet në paragrafin 3 të këtij neni.

Andaj, konform asaj që u tha më lartë, iu rekomandojmë që të veproni konform këtij opinioni, që të parandaloni konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Me respekt!